

BACHELOR NË “ARTE MUZIKORE”

(me profil: Kanto, Piano, Violinë dhe Harqe)¹

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Arte Muzikore” synon të përgatisë specialistë të muzikës të aftë si për të praktikuar muzikën, ashtu edhe për të vazhduar studime të mëtejshme në këtë fushë. Profilet e programit u mundësojnë studentëve të hyjnë në specifika më profesionale në fushën e muzikës, si kanto, apo instrumente muzikore si piano, violinë e harqe. Programi do të kombinojë njohuritë teorike me praktikën, duke i dhënë mundësi studenteve të shpalosin talentin dhe potencialin e tyre.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të studimeve, studenti do të jetë i aftë të:

- Performojë një repertor të larmishëm, si solist ose në ansambël, në skena, salla multifunktionale, dhe studio muzikore e televizive.
- Demonstrtojë aftësitë teknike dhe shprehitë e duhura artistike në ushtrimin e zërit apo instrumentit.
- Zhvillojë aftësi sipërmarrëse për të ndërtuar një karrierë të qëndrueshme si muzikant profesionist.
- Shpjegojë zhvillimet historike të muzikës dhe lidhjen e saj me kontekstet më të gjera kulturore, sociale dhe politike.
- Analizojë dhe interpretojë ndërtimin e veprave muzikore përmes periudhave historike, stileve dhe kulturave të ndryshme, duke përdorur kocepte teorike të avancuara.
- Vlerësojë në mënyrë kritike veprat muzikore, performancat dhe tekstet muzikore, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre historike dhe ndikimin kulturor dhe shoqëror, duke formuar argumente të mirëarsyetuara.
- Njohë dhe zbatojë teknologjinë muzikore dhe teknikat e ndryshme të prodhimit të tingullit dhe në instrumente dhe vokale.
- Zbatojë njohuritë mbi pedagogjinë muzikore për të hartuar dhe ofruar mësimë efektive, të përshtatura për stile të ndryshme të të nxënësve, dhe grupmosha në edukimin muzikor.
- Komunikojë idetë muzikore në mënyrë efektive, me shkrim, gojë dhe përmes performancës.
- Bashkëpunojë në mënyrë efektive në projekte artistike ndërdisiplinore dhe ndërkulturore.
- Demonstrtojë njohuri mbi industrinë e muzikës, përfshirë programimin e koncerteve, promovimin dhe çështje të të drejtave të autorit.

¹ Aktualisht aktiv është vetëm profili Kanto.



MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studentët që diplomohen në këtë programi studimi, mund të punësohen si:

- Specialistë pranë institucioneve qendrore dhe vendore në sektorë që lidhen me politikat e tyre për zhvillimin e artit dhe kulturës.
- instrumentist, korist, solist në institucione si Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, Radiotelevizioni Publik Shqiptar, televizionet kombëtare private, studio të ndryshme muzikore, edicionet e festivaleve të ndryshme muzikore.
- Kurator muzikor, drejtues artistik, ekspert projektesh të fushës së artit dhe kulturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Koordinator eventesh në institucione apo studio të ndryshme artistike.
- Mësues muzike, vetëm pas përfundimit edhe të studimeve master për mësuesi në fushën e arteve muzikore, dhe plotësimi të kriterëve për marrjen e licencës.

BACHELOR "ARTE MUZIKORE" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15% - 20%/ 32 ECTS

1	I	1	Hyrje në Filozofi	6
2	I	2	Shkrim Akademik dhe Metoda kërkimi	8
3	III	1	Komunikim ndërkulturor	6
4	I	1	Hyrje në sociologji	6
5	II	1	Hyrje në psikologji	6
				32

B - LËNDË KARAKTERIZUESE/ 50% - 55%/ 94 ECTS

1	I	1-2	Bazat e kantos/instrumentit I+II	10
2	I	1-2	Solfezh I+II	12
3	I	2	Histori muzike	10
4	II	1	Bazat e harmonisë	8
5	II	2	Analizë forme	8
6	II	1	Hyrje në regji (Regji 1)	6
7	III	2	Estetikë	6
8	II	2	Folklor	10
9	III	1	Muzikë dhome	10
10	III	1	Bazat e produksionit muzikor	6
11	III	2	Bazat e produksionit	8
				94

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE/ 12% - 15%/ 26 ECTS

PROFIL III			KANTO	
1	I	2	Piano Sekondare	3
2	II	1	Kanto I	5
3	II	2	Kanto II	5
4	II	2	Aktrim II	4
5	III	1	Kanto III	5
6	III	2	Kanto IV	5
				26

D - LËNDË PLOTËSUESE/ 10% - 15%/ 21 ECTS

1	I	1	Anglisht	5
2	II	1	Bazat e informatikës	4
3	II	2	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
3	III	2	Praktikë dhe zhvillim karriere	6
				21

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 3% - 5%/ 7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provim i Përgjithshëm Përfundimtar	7
---	-----	---	--	---

Totali

180